



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN140120210009

Tiranë, më: 08.04.2021

Vendimi 16

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi Juridik:** “BREMA AMBIENTE” sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L22316011G

**Adresa e selisë:** Rruga “Haxhi Kika”, Nd.5, H.3, Nj.A. Nr 5, 1022, Tiranë.

**Personi përgjegjës:** Selim Bregu

Për të zhvilluar projektin: “**Parku Industrial Rrashbull dhe Landfilli përkatës**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. / 10. Instalime për asgjësimin e mbetjeve, për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, të mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet mbi 50 tonë në ditë, sikurse përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

**Vendndodhja:** Rrashbull, Durrës.

**Të dhënat teknike:**

Kapaciteti: 1 000 000 m<sup>3</sup>

Sipërfaqja e pronës: 165 200 m<sup>2</sup>

Zona kadastrale: 2591, Nr.Pas. 1 dhe 2

*(Bashkangjitur vendimit, ANEKSI 1 me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:  
*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:***

Të sigurohet se toka e terrenit të përzgjedhur të plotësojë kërkesat lidhur me shtresat dhe padepërtueshmërinë e rrjedhjeve.

- Distanca dhe largësia e impiantit, nga zonat e banuara, të jetë në respektim të legjislacionit në fuqi dhe të mos çënojë jetën e banorëve dhe shëndetit përreth.

Landfilli të ndërtohet dhe të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi, në fushën e mbetjeve dhe të VKM 452/2012.

Drejtuesi teknik që do menaxhojë vendin e landfillit, të ketë eksperiencën e duhur në këtë fushë, të njohë shumë mirë TMD/TMM, të ketë kapacitetin e duhur teknik e menaxherial për këtë qëllim, duke i vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

Operatorët dhe stafi të landfillit të trajnohen vazhdimisht, nga ana profesionale, teknike; si dhe nga përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit.

Parku dhe landfilli të operohet duke ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve dhe për kufizimin e pasojave të tyre.

Të ngrihet qendra për përgjigje/reagim në rast emergjence.

Monitorimin e mjedisit në zonën përreth parkut, dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në zhvillimin dhe operimin e parkut dhe landfillit.

- Nëse dokumentacioni teknik dhe ligjor, është në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar, për fazën e ndërtimit shprehem si vijon:

Zbatimin me rigorozitet nga ana e subjektit, të planit të masave të propozuar në këtë raport për uljen e emetimeve në ajër dhe minimizimin në ndikimin negativ të cilësisë së ajrit, duke marrë në konsideratë;

i. Kontrollin e kushteve teknike në mënyrë periodike të mjeteve të punës për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve të gaztë, të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.

ii. Respektimin e normave të lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga automjetet rrugore, të përcaktuara sipas legjislacionit kombëtar në fuqi për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis.

iii. Monitorimin e lëndës së ngurtë pezull dhe Zbatimin e Planit të Monitorimit për ndikimin në mjedis, gjatë zbatimit të aktivitetit.

iv. Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse.

v. Spërkatjen e rregullt me ujë të sheshit të ndërtimit pas çdo procesi pune dhe rrugëve të transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij gjatë transportit të materialeve të ndërtimit. Forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë.

vi. Gjatë transportit, mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.

vii. Mjetet që do të sjellin lëndët e para do të lëvizin me shpejtësi të kontrolluar në mënyrë që të ulen rreziku i aksidenteve.

viii. Të sigurohen struktura pastrimi për automjetet/rrotat e automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit.

ix. Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së punimeve.

x. Vendosijen e sinjalistikës rrugore për menaxhimin dhe shmangien e trafikut;

xi. Subjekti të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM si dhe të zbatojë rekomandimet e lëna prej tij.

Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, nga bojrat, kimikatet që mund të përdoren gjatë procesit të ndërtimit, shprehem si vijon:

1. Subjekti dhe punëtorët duhet të jenë të familjarizuar me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e kimikateve: Ligji 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe aktet e dala në zbatim të tij, të cilat parashikojnë detyrime dhe rregulla për përdorimin e kimikateve dhe bojrave; marrjen dhe dhënien e informacionit mbi kimikatet në zinxhirin e furnizimit.

2. Prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi të informojnë përdoruesin apo shpërndarësin për rreziqet që mund të shkaktojnë një substancë ose përzierje dhe të japin informacion për trajtimin, ruajtjen dhe asgjësimin e sigurt të substancës apo përzierjes.

3. Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat, dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti.

4. Ruajtja dhe përdorimi i Bojrave dhe Kimikateve, që synohen të përdoren për qëllime të aktivitetit, të plotësojnë kërkesat, parashikimet e legjislacionit për menaxhimin e kimikateve dhe akteve të dala në zbatim të tij.

5. Me qëllim shmangien e efekteve të dëmshme në mjedis dhe shëndet, bojrat dhe kimikatet duhet të jenë të klasifikuara, etiketuara dhe paketuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Marrjen e masave për shmangien e rrezikut të rrjedhjeve, derdhjeve të karburantit apo lëndëve e tjera që synohen të përdoren gjatë fazës së zbatimit të projektit.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër: jep mendimin e saj pozitiv në lidhje me praktikën.*

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurua të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

- Në Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.
- Në kontratën “UZUFUKTI” për gëzimin e sipërfaqes tokë-truall, për ndërtimin dhe operimin e “Parkut Industrial Rrashbull”, Nr. 7165 Rep, Nr. 2190 Kol. datë: 17.06.2013, lidhur midis shoqërisë “Brema Ambiente” sh.p.k. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

- 4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**
- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2 Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.**
- 4.3 Kjo Deklaratë lëshohet vetëm për Parkun Industrial Rrashbull dhe Landfilli përkatës, sipas Aneksit 1, bashkangjitur.**
- 4.4 Ky instalim nuk do të shërbejë si landfill rajonal.**
- 4.5 Të shfrytëzohet sa më shumë, mundësia e rikuperimit apo dërgimit për rikuperim e kodeve të mbetjeve, që mund t'i nënshtrohen këtij procesi.**
- 4.6 Për kodet e mbetjeve që janë për asgjësim, të krijohet infrastruktura e duhur brenda parkut, me ndarjen përkatëse të qelizave në të cilat do të trajtohen mbetjet specifikisht, sipas rrymave, duke kryer operacionet bazuar në Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.**
- 4.7 Në fazën e aplikimit për Leje Mjedisore, infrastruktura për menaxhimin e mbetjeve, përvec të tjerave, duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:**
- Të ketë sipërfaqe të qëndrueshme, të papërshkueshme nga uji, lëngjet, substancat ndotëse, si dhe të jetë e hidroizoluar dhe me infrastrukturën përkatëse të grumbullimit dhe drenazhimit të ujërave sipërfaqësore, rrjedhjeve të mundshme të ujërave të shiut.
  - Të instalohet një dekantues për trajtimin e ujërave të ndotur, me qëllim eliminimin e substancave të rrezikshme.
  - Të sigurojë hapësira të përshtatshme brenda kufijve të pronës, për të bërë nfarjen e dhe depozitim të diferencuar të mbetjeve të ardhura në vendin e grumbullimit.
  - Të rrethohet sipërfaqja e objektit me mur, me qëllim parandalimin e rrjedhjes së ujërave sipërfaqësore brenda territorit të impiantit.
- 4.8 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.**
- 4.9 Të respektohet norma e shkarkimeve në ajër sipas VKM Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.**
- 4.10 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.**
- 4.11 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe funksionimit, sipas legjislacionit në fuqi.**
- 4.12 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.**
- 4.13 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.**
- 4.14 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.**

- 4.16** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, pra mbetjet inerte, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.17** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.18** Kompania duhet të respektojë gjithashtu sugjerimet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.19** Kapanoni i shkarkimit të mbetjeve dhe seleksionimit fillestar të jetë i shtruar me shtresa izoluese dhe fibra të posatshme që nuk lejojnë depërtimin në shtresat e tokës.
- 4.20** Trajtimi i mbetjeve në impiant të bëhet në një kohë sa më të shkurtër të mundshme duke ulur kohën e ekspozimit të tyre ndaj agjentëve të mjedisit
- 4.21** Ujërat e ndotura të gjitha kategorive të kapen e trajtohen në një impiant të posatshëm që do të jenë pjesë e projektit.
- 4.22** Subjekti të mbajë regjistër për sasinë e mbetjeve të trajtuara dhe të raportojë të dhënat çdo 6 muaj pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit të qarkut përkatës.
- 4.23** Kapanoni dhe zona operationale të kenë sistem të mbledhjes së ujërave sipërfaqësore dhe orientimin e tyre në impiantit e trajtimit të ujërave të ndotura
- 4.24** Të merren masa për sigurimin teknik në ambjentet e kompanisë, të bëhet sistemimi ajrosja e ventilimi i ambjentit.
- 4.25** Transportimi dhe trajtimi i mbetjeve të kryhet vetëm nga subjekte të licensuara.
- 4.26** Grumbullimi, transportimi, i mbetjeve të kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie
- 4.27** Para fillimit të procesit të punës subjekti duhet të hartojë një plan për administrimin e mbetjeve i cili duhet të rifreskohet çdo tre vjet.
- 4.28** Të bëhet trajnimi i personelit nga personel të çertifikuar, për marrjen e të gjitha masat e nevojshme të sigurisë;
- 4.29** Sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve, mbetjet duhen magazinuar të ndara nga njëra-tjetra, sipas kodeve të tyre.
- 4.30** Në rast se në vendin e stacionimit apo gjatë transportit, mbetjet e rrezikshme në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme, përzihen me mbetje të parrezikshme, këto mbetje më pas duhet të trajtohen si mbetje të rrezikshme.
- 4.31** Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre.
- 4.32** Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje duhet të ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.
- 4.33** Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

**4.34 Përvec zbatimit të kushteve të vendosura në deklaratë, subjekti duhet të paraqesë në dosjen e aplikimit për Leje Mjedisore, të gjitha kontratat me kompanitë, me të cilat do të bashkëpunojë.**

## **5. Monitorimi dhe Raportimi**

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### **- Zhurma dhe Vibracionet**

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

<b>Mjedisi</b>	<b>Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë</b>	<b>Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	10.10.2021	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	10.10.2021	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	10.10.2021	Çdo 6 muaj

### **- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	10.10.2021	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> 40 µg/m <sup>3</sup>	10.10.2021	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	10.10.2021	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
  - Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
  - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**

*Konceptoi:*

*Miratoi:*

## Aneksi 1. Harta me koordinatat

Koordinatat e Zones se Parkut Industrial dhe Lendfillit Perkates sipas sistemit Koordinativ KRGJSH			Koordinatat e Zones se Parkut Industrial dhe Lendfillit Perkates sipas sistemit Koordinativ Gaus Kruger		
Nr.	X	Y	Nr.	X	Y
1	4574325.43	462442.26	1	4575371.83	4378822.52
2	4574252.63	462414.26	2	4575299.34	4378793.68
3	4574267.33	462350.56	3	4575314.78	4378730.15
4	4574244.23	462240.66	4	4575292.94	4378619.97
5	4574235.83	462143.13	5	4575285.67	4378522.33
6	4574202.06	462131.37	6	4575252.02	4378510.18
7	4574095.66	462153.77	7	4575145.36	4378531.36
8	4574030.56	462156.57	8	4575080.22	4378533.41
9	4574041.76	462770.25	9	4575084.35	4379147.28
10	4574062.76	462731.05	10	4575105.8	4379108.32
11	4574118.06	462677.15	11	4575161.73	4379055.05
12	4574167.37	462586.11	12	4575212.09	4378964.57
13	4574261.55	462506.82	13	4575307.19	4378886.35
14	4574302.15	462490.72	14	4575347.98	4378870.72

